



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komiteti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

Nr. 05	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhja - Dëgjimi Publik së Bashku me Anëtarët e KPF-së,
Data e mbajtjes:	15.09.2022 në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut dhe
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës së Istogut
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Hajrush Shoshi, Faruk Kabashi, Liridona Lajqi, Ardita Idrizaj, Ajshe Metaj dhe Niman Beqiraj
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës Ali Nimanaj, Agim Ademaj, Drejtorat: Merita Muzliaj Bytyçi, Elianë Blakaj, Agon Dreshaj, Dukagjin Hoxhaj, Zenel Shatri, naim Behluli, zyrtar Administrativ: Jeta Balaj, Servete Haxhijaja, Alketa Bujupi Bytyçi, Flora Bujupi, OSCE Hysen Pelaj.
Rendi i ditës: 1. Shqyrtim i Propozimeve të dala nga Dëgjimi Publik me Qytetar për Draft Buxhetin e Komunës për vitin 2023-2025.	
Diskutimet: Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova , përshëndeti të pranishmit. Konstaton të gjithë anëtarët e KPF-së janë prezent, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Hapë punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje. Prezanton rendin e ditës, Hedh në votim kush është për miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së që kjo pikë të hy në rend dite. Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.	

Kush është qe të miratohet rendi i ditës. Miratohet rendi i ditës unanim nga anëtarët e KPF-së. Prezent në mbledhje janë të gjithë anëtarët e Komitetit	
Vendimet:	
Miratohet me shumicë votash rendi i ditës, me këtë propozim nga Kryetari i Komunës.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 1.	
Diskutimet:	
Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e rendit të ditës: Shqyrtim i Propozimeve të dala nga Dëgjimi Publik me Qytetar për Draft Buxhetin e Komunës për vitin 2023-2025, a ka dikush diçka? Propozimet e Qytetarëve: Nëntor Geca-kërkesë për rregullimin e trotuarit dhe ndriçimit publik në rrugën “Abetarja” në Banjë, Afrim Metaj- kërkesë për ndërtimin e shtëpisë së fshatit në fshatin Shushicë e Ulët. Bekë Alushaj-kërkesë të asfaltohet pjesa e fshatit në Shushicë rruga “ Dëshmorët Salihaj” Besim Metaj-kërkesë të shtrihet rrjeti i kanalizimit në fshatin Shushicë e Ulët. Sefadin Metaj-kërkesë të asfaltohen rrugicat në fshatin Shushicë e Ulët me gjatësi as 500 metra. Muharrem Metaj- kërkesë që në lagjen “Metaj” të vendoset ndriçimi përgjatë rrugës kryesore me gjatësi prej 1000 metra. Xhevat Camaj-kerkesë që të asfaltohet rruga “Ahmet Rugova” një kilometër. Shaban Muzliukaj-kërkesë për kanalizim dhe ujë të pijes në fshatin Uçë. Haki Rugovaj- kërkesë për transportin publik dhe jetën sociale. Skender Behluli- kërkesë për asfaltimin e rrugës “Mehmet Ujupi” për rregullimin e trotuarit, ndriçimit kanalizimit dhe asfaltimit në rrugën “Rrapi” në Dubravë. Bardh Bekaj- kërkesë për rregullimin e kanalizimit, trotuarit, ndriçimit dhe dy rrugicave tek lagjia “Bekaj” njëra 320 metra të cilën e keni në projekt që nga viti 2020 dhe tjetra 160 metra. Arianit Sejdiaj- kërkesë për asfaltimin e rrugës “Rrapi” dhe ndërtimin e urës që lidhet me rrugën “Qerim Kelmendi”. Fisnik Rugova- kërkesë për rregullimin e infrastrukturës së fshatit Carrallukë dhe asfaltimi i rrugëve lokale.	

Arlind Balaj- kërkesë për asfaltimin e lagjeve për fshatrat Lluga dhe Llukac i Begut për vitin 2023.

Arlind Balaj- kërkesë për ndriçimin në fshatin Lluga dhe Llukac i Begut, të jetë prioritet për vitin 2023.

Arlind Balaj- kërkesë për ndërtimin e kanalit të ujitjes në lagjen "Kukleci".

Ukë Dollci-kërkesë për kanalizim nga Istogu i Ulët deri te rruga "Xhevdet Dobrani".

Fidan Jahaj-kërkesë për asfaltimin e rrugës "Tahir Beka" deri Zhakovë lagjia " Idrizaj", kanalin e ujit, dhe kanalizimi pasi disa shtëpi nuk kanë kanalizim.

Imer Idrizaj- kërkesë për asfaltimin e rrugës nga lagjia "Jahaj" deri te "Idrizaj" të na japet një parcelë për varreza dhe të zgjidhet problemi për ujë të pijes.

Kryesuesi i Kuvendit – këto janë propozimet e qytetarëve.

Pasi që nuk ka diçka tjetër, faleminderit që ishit pjesë e kësaj mbledhje, dhe dhatë kontributin e juaj.

Vendimet:

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit

Verejtje :

Kryesuesi i kuvendit, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj : 10:30

Procesmbajtëse,
Znj. Vjosa Hysenaj



Kryesuesi i Kuvendit,
z. Enver Rugova

